

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"KUBE PRODUCTION" Sh.p.k.**

Sot më datë 15.06.2024, ne Tirane, themeluesi Z. Erfort Pali Kuke, lindur ne Tirane, I datelindjes 17.04.1980, mbajtes I dokumentit identifikues me numer I00417165J, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, ka vendosur të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "KUBE PRODUCTION" SH.P.K, aktiviteti i së cilës ushtrohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, përkatësisht me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të Ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 “ Për Qëndrën Kombëtare te Biznesit” si dhe me Statutin e shoqërisë, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

**Neni 1 - Emërtimi**

**1.1** Shoqëria emërtohet "KUBE PRODUCTION" SH.P.K (në vijim“Shoqëria”).

**Neni 2 – Selia**

**2.1** Selia e Shoqërisë është në adresën: “ Rruga Mihal Duri, Nr. 123/3, Tirane, Shqipëri”

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

**3.1** Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë pa afat dhe mund të ndryshohet në vazhdim me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 4 - Objekti**

**4.1** Shoqëria ka për objekt veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të përshkruara në vijim:

**“Realizim Production dhe Post Production. Prodhimi dhe tregtimi i produkteve të arkitekturës, dizajnit dhe artizanatit, art, pikturë, skulpturë, instalacione artistike etj; Prodhimi dhe shpërndarja e botimeve dhe publikimeve; Ofrimi i shërbimeve konsulence për muze, galeri mbi muzealizimin, instalacionin e ekspozitave, instalacionet teknologjike dhe digjitale; Shërbime Kuratoriale dhe Menaxhuese për evente, aktivitete etj. Ofrimi i shërbimeve të dizajnit grafik dhe të aplikuar; Ofrimi i shërbimeve të ndryshme të prodhimit audioviziv: drejtim artistik, regji, montazh, fotografi, postproduksion, color correction, dizajn dhe mixim audio, skenar etj; Krijim dhe menaxhim fushatash komunikimi si dhe fushata promovionale; Kërkim dhe Hulumtim artistik; Regjistrime, xhirime filmike audio, video. Veprimtari në fushën imobiliare. Zhvillimi dhe administrimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, shit-blerja, marrja dhe dhënia me qira e nënqira e tyre. Veprimtari në fushën ndërtimore. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion**

**tjeter pa u kufizuar që ka të beje me pronën e paluajtshme apo të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër tregtar, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues, me qëllim përmbushjen e objektit të saj, si dhe cfarëdolloj aktiviteti tjetër dytësor, komplementar, plotësues të nevojshem ose të përshtatshëm në lidhje me sa më sipër me kusht që të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.”**

- 4.2** Shoqëria mund (i) të marrë pjesë me financime ose në mënyrë operative ose (ii) të zotërojë, të blejë ose të shesë pjesëmarrje në ente, shoqëri apo ndërmarrje, edhe në fazë themelimi që kanë qëllime të ngjashme, komplementare apo gjithsesi të lidhura me të dhe objektin e saj.
- 4.3** Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme apo të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër tregtar, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues, me qëllim përmbushjen e objektit të saj, si edhe çdo aktivitet tjetër të pranuar nga ligji.

### **Neni 5 - Kapitali i Shoqërisë, kontributet dhe kuotat**

- 5.1** Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 100,000.00 (njëqind mijë) Lekë dhe është në 1(nje) kuote e zoteruar 100% nga themeluesi Z.Erfort Kuke.
- 5.2** Kontributi mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

### **Neni 6 - Transferimi i kuotave**

- 6.1** Kuotat transferohen sipas parashikimeve të Statutit.

### **Neni 7 - Administrimi**

- 7.1** Me këtë akt emërohet si Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:
- themeluesi Z. Erfort Pali Kuke, lindur ne Tirane, I datelindjes 17.04.1980, mbajtes I dokumentit identifikues me numer I00417165J, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.
- 7.2** Administratorit i takon përfaqësimi i Shoqërisë kundrejt të tretëve, në gjykatë, dhe i takojnë kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë në zbatim të nenit 95 të ligjit nr. 9901 të datës 14.04.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”* (“Ligji Tregtar”) dhe në çdo rast në përputhje dhe në kufijtë e kompetencave të përcaktuar në vendimin e emërimit.
- 7.3** Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe përmbushjen e detyrimeve të parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve, të cilëve mund t'u delegojë në tërësi ose pjesërisht kryrjen e aktivitetit të sipërpërmëndur.

**7.4** Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e saj personave të tjerë.

### **Neni 8 - Gjuha**

**8.1** Ky Akt Themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe. Për çdo konflikt që rrjedh nga zbatimi dhe/ose interpretimi i këtij akti, të dy kopjet kanë fuqi legislative të barabartë, versioni në shqip do të jetë i vetmi dhe do të jetë ligjërish detyrues.

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, ortakut I vetem themelues deklaron, se ky Akt Themelimi I shoqërisë “KUBE PRODUCTION” sh.p.k u hartua dhe nënshkrua në datën e sotme me 15.06.2024, me vullnetin e tij të plotë e të lirë.

**Tirane, më 15.06.2024**

**PER SHOQERINE  
“KUBE PRODUCTION” SHPK  
ORTAKU THEMELUES**

**Z. ERFORT KUKE**

